



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.320/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve: H. D., T. F. dhe B. E., për shkak të veprës penale në vazhdim kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarve, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.42/2022 të datës 14.09.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.663/2023 të datës 09.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 29 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve H. D., T. F. dhe B. E. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.42/2022 të datës 14.09.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.663/2023 të datës 09.01.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.42/2022 e datës 14.09.2023, të dënuarit H. D., T. F. dhe B. E., i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale në vazhdim kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.5 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i ka gjykuar të dënuarin H. D. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijepesëqind) €, të dënuarin T. F. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 5 (pesë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijepesëqind) €, kurse të dënuarin B. E. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijepesëqind) €. Të dënuarit janë obliguar secili veç e veç në pagesën e shumës prej nga 150 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej nga 50 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.663/2023 e datës 09.01.2024, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e mbrojtësve të të dënuarve duke ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënim në atë mënyrë që për veprën penale të shpallur fajtor i ka gjykuar të dënuarin H. D. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tetë) muaj, të dënuarin T. F. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse të dënuarin B. E. me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse në pjesët tjera aktgjykimi është vërtetuar. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren është refuzuar si e pabazuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit H. D., avokati Festim Shala nga M., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të i anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të dënuarit të i shqiptoj dënim më të butë;

- mbrojtësi i të dënuarit T. F., avokati Berat Tmava nga P., për shkak të shkeljes esenciale së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e

Kosovës të i anulohet aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të dënuarit të i shqiptoj dënim më të butë;

- mbrojtësi i të dënuarit B. E., avokati Valdet Hoxha nga P., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të i anulohet aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të dënuarit të i shqiptoj dënim më të butë;

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.180/2024 e datës 23.05.2024 ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit H. D. thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse arsyetimi i aktgjyqimeve është i paqartë dhe nuk përmban arsye të mjaftueshme për rrethanat vendimtare në këtë çështje penale.

Pretendohet për shkelje të ligjit penal, meqë krahas rrethanave lehtësuese të theksuara në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë marrë parasysh edhe rrethana tjera lehtësuese dhe atë sjellja e mirë e treguar e të dënuarit, se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale dhe fakti se ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e veprës penale dhe se i dënuari është i gjendjes së varfër ekonomike dhe i cili ka premtuar se nuk do të kryejë vepra tjera penale.

Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit T. F. theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse përbërja dhe forma e aktgjyqimit në formë të shkruar është përcaktuar sipas dispozitës ligjore të nenit 369 të KPP-së dhe sipas kësaj dispozite nuk e liron gjykatën në paraqitjen e arsyetimit edhe kur bëhet pranimi i fajësisë. Përkundër faktit se pranimi i fajësisë është zgjedhja e të dënuarit, megjithatë gjykata duhet të ketë kujdes se i dënuari a e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Për më tepër, theksohet fakti se në seancën e datës 10.08.2023 është kërkuar që gjykata e shkallës së parë të përcaktoj afat për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe i cili negocim

nuk është arritur, mirëpo prokurori i shtetit ka propozuar që me rastin e pranimit të fajësisë dënimet e shqiptuara të jenë nën minimumin e dënimit duke marrë parasysh edhe zbutjen e dënimit të cilën duhet të bëhet po ashtu në minimum, kurse kjo nuk është përfillur nga ana e gjykatës e cila ka shqiptuar dënime nën minimumin ligjor por jo në minimum të zbutjes së dënimit.

Duke theksuar përkitazi me shkeljet e ligjit penal, pretendohet se është shkelur në dëm të të dënuarit me rastin e shqiptimit të dënimit i është shqiptuar dënim i ashpër.

Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit B. E. e cila ka përmbajtje të njëjtë me kërkesën e të dënuarit T. F., theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse përbërja dhe forma e aktgjyimit në formë të shkruar është përcaktuar sipas dispozitës ligjore të nenit 369 të KPP-së dhe sipas kësaj dispozite nuk e liron gjykatën në paraqitjen e arsytimit edhe kur bëhet pranimi i fajësisë. Përkundër faktit se pranimi i fajësisë është zgjedhja e të dënuarit, megjithatë gjykata duhet të ketë kujdes se i dënuari a e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Për më tepër, theksohet fakti se në seancën e datës 10.08.2023 është kërkuar që gjykata e shkallës së parë të përcaktoj afat për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe i cili negociim nuk është arritur, mirëpo prokurori i shtetit ka propozuar që me rastin e pranimit të fajësisë dënimet e shqiptuara të jenë nën minimumin e dënimit duke marrë parasysh edhe zbutjen e dënimit të cilën duhet të bëhet po ashtu në minimum, kurse kjo nuk është përfillur nga ana e gjykatës e cila ka shqiptuar dënime nën minimumin ligjor por jo në minimum të zbutjes së dënimit.

Duke theksuar përkitazi me shkeljet e ligjit penal, pretendohet se është shkelur në dëm të të dënuarit me rastin e shqiptimit të dënimit i është shqiptuar dënim i ashpër.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit Të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave janë parashtruar kërkesat, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit H. D., Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo gjykatë gjen se në fakt nuk është paraqitur ndonjë pretendim konkret dhe i qartë por vetëm se është bërë citimi i dispozitave ligjore, andaj si të tilla në kuptim të nenit 436 par.1 të KPP-së del se kjo gjykatë i është përmbajtur parimit se kufizohet vetëm me verifikimin e shkeljeve ligjore dhe për këtë arsye konstatoi se pretendimet në fjalë dalin të jenë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar tutje pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve T. F. dhe B. E., konstatoi se të dënuarit në shqyrtimin fillestar dhe në prani të mbrojtësve të tyre kishin bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPP-së, atëherë, pranimi i fajësisë është aprovuar. Për më tepër, aspektet e negociimit të marrëveshjes së fajësisë nuk janë objekt i shqyrtimit të kësaj gjykate, meqë bazuar në shkresat e kësaj çështje del se çështja është përfunduar me seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe se në këtë seancë është bërë pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarve.

Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me vlerësimin e rrethanave me rastin e shqiptimit të dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga të dy gjykatat e instancave më të ulëta dhe të dënuarve u është shqiptuar dënimi i përcaktuar brenda kornizës së minimumit dhe maksimumit të dënimeve të përcaktuara për veprat penale për të cilat të dënuarit janë shpallur fajtor, për më tepër, janë aplikuar edhe dispozitat e zbutjes së dënimit. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPPK-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës

shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkuluar kompetencat ligjore dhe arsytet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.320/2024, më 29 maj 2024

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka